



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E GJAKOVËS
OSNOVNI SUD GJAKOVA – BASIC COURT OF GJAKOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
AGJ.I.nr. 135/2023
Datë 15.05.2023

Në bazë të nenit 14 të Ligjit për Gjykatat (nr. 06/L-054), Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nenit 11 par. 1, 3, 7 dhe 12, si dhe nenit 17 par. 1, 3, 4, 5, 6 të Rregullores mbi Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave, si dhe planit vjetor të punës së Gjykatës Themelore në Gjakovë me dy degët në Rahovec dhe Malishevë, kryetari i Gjykatës Nikollë Komani, pas marrjes së propozimit të kolegjiut të kësaj Gjykate, me datën 15.05.2023 përcakton:

**PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E PLANIT VJETOR TË PUNËVE TË GJYQTARËVE
DHE ADMINISTRATËS SË GJYKATËS THEMELORE NË GJAKOVË DHE DY DEGËVE
NË RAHOVEC DHE MALISHEVË**

Neni 1

Kryetari i Gjykatës, bazuar në kompetencat ligjore që ka për organizimin e punës së gjyqtarëve dhe administratës së Gjykatës, si rezultat i ndryshimeve që kanë ndodhur pas hartimit të planit vjetor të punës së Gjykatës Themelore në Gjakovë me dy degët e saja, e kjo si rezultat se gjyqtarët e rinjë Fëllanza Knushaj, Samedin Cena dhe Berkan Hamza, do të ngarkohen me lëndë dhe janë caktuar në lëmin që do të punojnë si dhe bazuar në faktin se gjyqtarja Myfera Hoxha, e arrin moshën e pensionimit me datë 07.06.2023, ndërsa gjyqtarja Afijete Sada-Gllogjani, e arrin moshën e pensionimit me datë 21.07.2023, është paraqitur si domosdoshmëri riorganizimi i punës së Gjykatës me dy degët e saj. Andaj bazuar në kompetencat ligjore ka thirrur kolegjiutin e Gjykatës Themelore në Gjakovë me dy degët e saj, për plotësimin dhe ndryshimin e raporteve të punës.

Neni 2

2.1. Gjyqtarja Fëllanza Knushaj caktohet që të punoj në Departamentin e Përgjithshëm - Divizionin Civil dhe e njëjta do të ngarkohet me lëndët civile me të cilat ka qenë e ngarkuar gjyqtarja Afijete Sada-Gllogjani, e cila do të pensionohet me datë 21.07.2023.

2.2. Gjyqtari Samedin Cena, caktohet që të punoj gjyqtar në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal, dhe i njëjti do të ngarkohet me lëndët penale me të cilat ka qenë e ngarkuar gjyqtarja Diana Sina, e cila është pensionuar me datë 27.03.2023.

Neni 3

Meqenëse gjyqtarja Myfera Hoxha, do të pensionohet me datë 07.06.2023 dhe e njëjta ka trajtuar lëndët e kundërvajtjes atëherë këto lëndë përmes programit të SMIL-it, do të ju ndahen në mënyrë të barabartë gjyqtarëve Ilirijana Hoti dhe Samedin Cena, të cilët përpos lëndëve penale në Departamentin e Përgjithshëm Penal do ti trajtojnë edhe lëndët e kundërvajtjes.

Neni 4

Gjyqtari Berkan Hamza, caktohet që të punoj gjyqtar në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Civil në degën në Rahovec dhe i njëjti do të ngarkohet me lëndët civile të të gjitha natyrave.

Neni 5

Ky plotësim ndryshim i planit vjetor të punës është pjesë përbërëse e planit vjetor të punës së Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe dy degëve në Rahovec dhe Malishevë, AGJ.I nr. 290/2022 të datës 27.12.2022, i cili plan në pjesën që nuk është ndryshuar mbetet në fuqi.

Neni 6

Me këtë ndryshim të planit të punës njoftohet Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

